



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 201, datë 29.12.2020

MBI
FONDIN E KOMPENSIMIT PËR VITIN 2021

Në bazë dhe për zbatim të neneve 13, 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 45 e vijues të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Për vitin 2021, masa e Fondit të Kompensimit, të jetë në vlerën 150,000,000 lekë.**
- 2. Provigjonet për shpenzime të Fondit të Kompensimit do të krijohen në vlerën prej 632,369,620 lekë, të cilat do të pasqyrohen nga shoqëritë e sigurimit, në pasqyrat financiare të vitit 2020.**
- 3. Fondi i Kompensimit dhe provigjoni i parashikuar, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi, do të rishikohen në fund të tremujorit të parë të vitit 2021.**
- 4. Byroja Shqiptare e Sigurimit:**
 - 4.1 Të llogaritet dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive të Fondit të Kompensimit, sipas pikës 1 të këtij vendimi;**
 - 4.2 Të llogaritet dhe të njoftojë shoqëritë e sigurimit për vlerën respektive për krijimin e provigjonit për shpenzime sipas pikës 2, të këtij vendimi.**
- 5. Ngarkohet Drejtoria e Zbatueshmërisë dhe Parandalimit të Pastrimit të Parave, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE